



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV

Nr. 923/119 prot.

Tiranë më 19.10.2020

REKOMANDIM

Nr. 23, datë 19.10.2020

PËR KONTROLLUESIN "IUTE CREDIT ALBANIA" SHA

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar (në vijim, "Ligji"), ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" (në vijim, "Kodi i Procedurave Administrative"), si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "Iute Credit Albania" SHA,

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 139, datë 03.09.2020 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, "Komisioneri"), u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit "Iute Credit Albania" SHA (në vijim, "Kontrolluesi"), me objekt:

- Verifikimi i ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga znj. V.L. në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale dhe zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë kontrolluesit, konstaton se:

1. Kontrolluesi është një shoqëri e cila ka për objekt të veprimtarisë së saj: "dhënie e kredive si dhe çdo veprimtari tregtare lidhur me kredidhënie".

Gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tij tregtare, Kontrolluesi përpunon të dhëna personale për kategoritë e subjekteve të të dhënave "punëmarrës, klientë dhe vizitorë". Të dhënat përpunohen manualisht, si dhe nëpërmjet instrumenteve elektronike.

2. Kontrolluesi, ka lidhur marrëveshjen “Për mbledhjen e detyrimeve të pa-arkëtuara”, datë 01.12.2018, me përpunuesin “Elite Consulting” SHPK (në vijim, “Përpunuesi”), i cili ka në objekt të veprimtarisë së tij, ndër të tjera: “ndërmjetësimin tregtar dhe mbledhjen e kredive të këqija”.

Kontrolluesi, ka vendosur në dispozicion të Përpunuesit, të dhënat e debitorit E.L., duke përfshirë: emër, mbiemër, adresën, shumën e kredisë, statusin martesor, të dhënat e pagës dhe emrin e punëdhënësit.

Kontrolluesi përcjell të dhënat e mësipërme pranë Përpunuesit në rrugë elektronike, për të vijuar me procedurën e mbledhjes së borxhit.

Në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga Kontrolluesi, nuk rezulton të jenë përpunuar të dhënat personale të ankueses znj. V.L., e ëma e debitorit (emër, atësi, mbiemër). Kontrolluesi dhe Përpunuesi kanë nënshkruar një kontratë për përpunimin e të dhënave personale në zbatim të marrëveshjes për mbledhjen e detyrimeve të pa-arkëtuara.

3. Kontrolluesi nuk ka verifikuar ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale të deleguar pranë përpunuesit “Elite Consulting” SHPK. Konstatohet se “Elite Consulting” SHPK, nuk ka depozituar njoftimin për përpunimin e të dhënave personale, pranë Zyrës e Komisionerit, sipas detyrimit të parashikuar në nenin 21 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se realizimi i detyrimit për njoftim, për përpunimin e të dhënave personale, është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin që kryen Kontrolluesi (dhe/ose përpunuesi i këtij të fundit) dhe realizimin e detyrimeve ligjore të këtij të fundit. Kjo i jep mundësi reale subjekteve të të dhënave për të ushtruar në mënyrë korrekte të drejtat që i rezervojnë shprehimisht dispozitat e Ligjit.

Në bazë të nenit 20 të Ligjit, për qëllime të veprimtarisë së tij, Kontrolluesi mund të angazhojë përpunues të cilët garantojnë përdorimin e ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave.

Në këtë kontekst, në bazë të udhëzimit nr. 19, datë 03.08.2012, të Komisionerit “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi” i ndryshuar (në vijim, “Udhëzimi nr. 19”), Kontrolluesi, ndër të tjera, është i detyruar të përzgjedhë përpunues që ofrojnë garanci të qëndrueshme që sigurojnë të dhënat personale që do të përpunohen.

Neni 21 i Ligjit përcakton se çdo kontrollues, përpara se të fillojë përpunimin e të dhënave, duhet të njoftojë Zyrën e Komisionerit, nëpërmjet një formulari standard njoftimi.

Rrjedhimisht, “*Elite Consulting*” SHPK, përpara se të vishej me cilësinë e përpunuesit sipas marrëveshjes së treguar në pikën 2 të këtij rekomandimi, do të duhej të kishte depozituar rregullisht njoftimin përkatës pranë Zyrës së Komisionerit.

“*Elite Consulting*” SHPK, për qëllime të veprimtarisë së saj, është një kontrollues në kuptim të pikës 5 të nenit 3 të Ligjit dhe cilësinë e përpunuesit, në rastin konkret, e bart vetëm në bazë të marrëveshjes me “*Iute Credit Albania*” SHA, parakushtëzuar nga përmbushja e detyrimeve përkatëse si kontrollues.

Mosdepozitimi i formularit të njoftimit pranë Zyrës së Komisionerit është një shkelje e sanksionueshme administrativisht në dëm të vetë “*Elite Consulting*” SHPK.

Mirëpo, nga ana tjetër, shkelja e nenit 21 të Ligjit nga “*Elite Consulting*” SHPK përkthehet edhe në shkelje të nenit 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19 nga ana e “*Iute Credit Albania*” SHA, pasi kjo e fundit nuk do të duhej të kishte angazhuar, për përpunimin e të dhënave personale të klientëve të saj, një subjekt i cili nuk vepron në përputhje me dispozitat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe kësaj, nuk garanton as përdorimin e ligjshëm të të dhënave personale të subjekteve përkatëse (klientëve), si dhe as të drejtën e këtyre të fundit për të ushtruar në mënyrë korrekte të drejtat që i rezervojnë shprehimisht dispozitat e Ligjit.

4. Në nenin 10 të “*Manualit për përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, Kontrolluesi ka parashikuar rregulla specifike për përpunimin e dy kategorive të të dhënave sensitive të punonjësve: Gjendja penale dhe gjendja shëndetësore.

Konstatohet se kontrolluesi nuk ka dokumentuar rregullat e nevojshme për funksionimin e sistemit të aksesit nëpërmjet gjurmëve biometrike (gishti tregues) në mjediset e punës, sipas detyrimeve të parashikuara në pikën 2/1 të nenit 27 të Ligjit dhe në pikat 8 dhe 9 të Udhëzimit nr. 11, datë 08.09.2011 “*Për përpunimin e të dhënave personale të punonjësve në sektorin privat*” i ndryshuar (në vijim, Udhëzimi nr.11).

Zyra e Komisionerit vlerëson se përdorimi i të dhënave biometrike mund të legjitimohet vetëm në raste specifike dhe si një mjet i fundit për të garantuar sigurinë, sipas përcaktimeve në Udhëzimin nr. 11.

Masat teknike, rregullat e funksionimit të sistemit të aksesit, mënyra dhe afati i ruajtjes së tyre, duhet të dokumentohen në rregulloren e brendshme për ruajtjen, përpunimin dhe sigurinë e të dhënave personale.

5. Kontrolluesi ka ndërmarrë masa në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale lidhur me legjislacionin Shqiptar në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, duke përgatitur një modul trajnimi. Procesi trajnues zhvillohet nga Personi përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale në dy seanca. Programi përmban temat: Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale; të drejtat

e individit si subjekt i të dhënave personale; detyrimet e kontrolluesit dhe përpunuesit; vëzhgimi me kamera dhe mbrojtja e të dhënave personale; Përpunimi i të dhënave personale të punonjësve; etj.

Nga ana tjetër, konstatohet mosplotësim i detyrimeve në lidhje me administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të menaxhimit së sigurisë së informacionit (SMSI) lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, të parashikuara nga udhëzimi nr. 47, datë 14.09.2018 *“Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha”* (në vijim, *“Udhëzimi nr. 47”*).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veprimitarisë që ushtron, e cila kërkon masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale, Kontrolluesi, është i detyruar të mirëmbajë dhe administrojë SMSI në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr. 47.

SMSI për mbrojtjen e të dhënave personale duhet të bazohet në standardin ISO/IEC 27001, siç parashikohet në nenin 5 të Udhëzimit nr. 48, datë 14.09.2018, të Komisionerit *“Për certifikimin e sistemeve të sigurisë së informacionit, të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre”* (në vijim, *“Udhëzimi nr. 48”*), si dhe është një sistem i certifikueshëm, për qëllime përputhshmërie me standardin e sipërpërmendur, vetëm nga organizma të akredituar dhe autorizuar sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 48.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit hartoi procesverbalin përkatës, i cili u nënshkrua nga përfaqësuesi i kontrolluesit.

Me shkresën nr. 734 Prot., datë 29.09.2020, me objekt *“Komente në lidhje me procesverbalin e hetimit administrativ”*, Kontrolluesi ka paraqitur pretendimet e tij me shkrim si vijon:

- Lidhur me konstatimin se Kontrolluesi nuk ka verifikuar ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale të deleguar pranë përpunuesit *“Elite Consulting”* SHPK, pasi ky i fundit, nuk ka depozituar njoftimin për përpunimin e të dhënave personale, pranë Zyrës së Komisionerit, sipas detyrimit të parashikuar në nenin 21 të Ligjit, Kontrolluesi pretendon se e ka kryer njoftimin duke deklaruar edhe përpunuesin në Formularin e Njoftimit, dhe nuk mund të mbajë përgjegjësi për mos-realizimin e këtij detyrimi nga përpunuesi.
- Lidhur me konstatimin se Kontrolluesi nuk ka dokumentuar rregullat e nevojshme për funksionimin e sistemit të aksesit nëpërmjet gjurmëve biometrike (gishti tregues) në mjediset e punës, sipas detyrimeve të parashikuara në pikën 2/1 të nenit 27 të Ligjit dhe në pikat 8 dhe 9 të Udhëzimit nr. 11, pretendohet se në nenin 9 të Manualit *“për*

*ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale*”, është parashikuar se punonjësve u merren të dhëna biometrike për aksesin në mjediset e Zyrës Qendrore, por ato nuk gjurmohen deri në identifikimin e individit. Gjithashtu, Kontrolluesi ka treguar në mënyrë narrative në parashtrimet e tij, mënyrën e funksionimit të këtij sistemi, si dhe provat bashkëlidhur.

- Lidhur me mosplotësim e detyrimeve për administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të menaxhimit së sigurisë së informacionit (SMSI), të parashikuara nga Udhëzimi nr.47, Kontrolluesi ka kërkuar informacion orientues mbi bazën ligjore dhe mënyrën e përmbushjes së këtij detyrimi.

Në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesi i kontrolluesit është paraqitur në seancën dëgjimore të organizuar nga Zyra e Komisionerit, duke i qëndruar pretendimeve të dërguara me shkrim.

Lidhur me pretendimet dhe provat e paraqitura nga kontrolluesi mbi konstatimet e evidentuara nga grupi i inspektimit në procesverbalin e hetimit administrativ, Zyra e Komisionerit vlerëson se detyrimi i kontrolluesit për të verifikuar se përpunuesi garanton ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave, buron nga neni 20 i ligjit. Në këtë kuadër, detyrimi për njoftim pranë Zyrës së Komisionerit *ipso iure* është ndër elementët parësorë të ligjshmërisë së përpunimit. Gjithashtu, mosparashikimi i mënyrës funksionimit të sistemit të identifikimit në rregulloren për mbrojtjen e të dhënave personale, pasi në rregulloren e administruar, gjendet vetëm citimi i këtij sistemi, por jo mënyra e operimit të tij, është në kundërshtim me nenin 27 të ligjit.

Si përfundim, Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e kontrollit administrativ dhe reagimin e tij për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara. Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm, pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe ndalon mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Sa më sipër, në zbatim të neneve 20, 27, 29, 30, 31 (pika 1, gërma “a/1”), si dhe 32 të Ligjit,

#### **R E K O M A N D O J:**

1. Kontrolluesi në zbatim të nenit 20 të ligjit, të marrë masa për të verifikuar ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave pranë përpunuesve të të dhënave.

2. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, si dhe dispozitave të Udhëzimit nr. 11, të parashikojë rregulla specifike për mënyrën e funksionimit të sistemit të identifikimit biometrik të punëmarrësve që aksesojnë zyrat qendrore të shoqërisë;
3. Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale, të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47, lidhur me trajnimin e stafit të tij, si dhe sa i përket mirëmbajtjes dhe administrimit të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) për mbrojtjen e të dhënave personale.

SMSI për mbrojtjen e të dhënave personale duhet të ndërtohet në përputhje me standardin ISO/IEC 27001, siç parashikohet në nenin 5 të Udhëzimit nr. 48, si dhe mund të certifikohet, për qëllime përputhshmërie me standardin në fjalë, nga organizma të akredituar dhe autorizuar në përputhje me dispozitat e këtij udhëzimi. Në këtë rast, Kontrolluesi, në zbatim të germës "b" të pikës 42 të Udhëzimit nr. 47, depoziton pranë Zyrës së Komisionerit një kopje të certifikatës së përputhshmërisë;

4. Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:
  - (i) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimet e parashikuara në pikat 1, dhe 2 më sipër;
  - (ii) brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve, detyrimin e parashikuar në pikën 3.

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data marrjes dijeni të këtij akti.

5. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra.

Në rast mospërmbushjeje, të detyrimeve të parashikuara në këtë akt, Komisioneri vepron sipas pikës 2 të nenit 30 dhe nenit 39 të Ligjit të cilët parashikojnë se në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të Ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, Komisioneri vendos sanksione administrative për kundërvajtjet administrative përkatëse dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 13.10.2020.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

